



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-2226/1 të datës 15.03.2022 me pretendime kundër një personi fizik nga ---
-----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se në denoncimin e dorëzuar nuk ka pretendime apo indikacione për veprime të kundërligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, si dhe për faktin se i denoncuari nuk është zyrtar në kuptim të nenit 8 paragrafi 2 të të njëjtit ligj, andaj pretendimet e paraqitura nuk ofrojnë bazë për inicimin e çdo procedurë për të cilën KSHPK është kompetente sipas ligjit.

Lënda me numër 12-2226/1 të datës 15.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 15.03.2020 është bërë kërkesë nga një parashtrues i panjohur, me numër 12-2226/1, datë 15.03.2022, kundër një personi fizik nga -----, ish punonjës i -----, për shkak të regjistrimit në kadastrën e pasurive të paluajtshme të pasurisë së tij pa dijeninë e ish-punonjësve të tjerë. Në rastin konkret bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme të transformuara me kontratë për transformim dhe privatizim dhe që është dashur të kalonin në pronësi të ish-punonjësve të stacionit veterinar, por parashtruesit dyshojnë se i kallëzuar i ka mashtruar dhe pa njohjen e tyre ka përfunduar procedurën vetëm për pjesën e tij të pasurisë.

Gjatë shqyrtimit të raportit në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi i dorëzuar nuk përmban pretendime që i referohen personave dhe veprimtarive të veçanta dhe nuk ka pretendime apo indikacione për veprime të kundërligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushtetit publik dhe të detyrave zyrtare, gjithashtu i denoncuari nuk është zyrtar në kuptim të nenit 8 paragrafi 2 të të njëjtit ligj, ndërsa konstaton se pretendimet e paraqitura në kërkesë nuk ofrojnë bazë për fillimin e ndonjë procedure për të cilën KSHPK-ja është kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprimin e saj kompetent për rastin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR

PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska

Përgatiti: J.C.
Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

